

KDU 004 (05)

Kodix

nr.4

Revistë e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiilan, Mars 2018



**CEREMONIA E DIPLOMIT TË STUDENTËVE
NË UKZ – NGJARJE E MADHE PËR GJILANIN**



Revistë e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

Redaktor përgjegjës:

Prof.asoc.dr. Xhevdet Thaqi

Redaktor teknik:

Jeton Selimi

Këshilli redaktues:

Prof.asoc.dr. Xhevdet Thaqi
Prof.ass.dr. Ragmi Mustafa
Prof.ass.dr. Basri Ahmedi
Prof.ass.dr. Ekrem Halimi
Prof.ass.dr. Artan Dermaku
Prof.ass.dr. Merxhan Avdyli
Ligj.phd.c. Lindita Nebiu Hyseni
Ligj.phd.c. Nysret Demaku
Gëzim Kastrati
Endrina Spahiu
Jeton Selimi

Botoi:

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike

Adresa:

rr. Zija Shemsu, pn. 60000, Gjilan,
Republika e Kosovës

Email:

info.kodix@uni-gjilan.net

Website:

<http://uni-gjilan.net/revista-kodi-x>

Shtypi: FSHK

Revista KODI X shënon ecjet e UKZ-së dhe FSHK-së

Lexuesve të revistës KODI X u sjellim numrin 4, pikërisht në vitin kur bëhen 5 vjet nga themelimi i Universitetit "Kadri Zeka", periudhë kjo kur Universiteti Publik "Kadri Zeka" ka realizuar hapa të mëdhenj në procesin e rritjes së tij.

Në këtë numër, KODI X do të shënojë momentet më të rëndësishme nga muaji prill i vitit 2017 deri në fillim të vitit 2018. Prandaj, në faqet e këtij numri të revistës KODI X do të fillojmë të përshkruajmë procesin e rëndësishëm të institucioneve të arsimit të lartë – akreditimin institucional dhe të programeve studimore të Universitetit "Kadri Zeka", i cili rezultoi me riakreditimin e UKZ-së, si institucion universitar për periudhën e ardhshme 3-vjeçare (deri në vitin 2021), riakreditimin e programeve të studimeve bachelor dhe sidomos akreditimin e dy programeve të studimeve master – që është rezultat i rëndësishëm i UKZ në rritjen e saj, por edhe një dhuratë e madhe për Gjilanin, duke u ofruar për herë të parë studime master të gjithë të rinjve të rajonit të Gjilanit dhe më gjerë.

Në vitin 2017 u diplomuan studentët e parë të UKZ-së dhe të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, duke shënuar rezultate interesante dhe të dobishme, si për FSHK-në, ashtu edhe për komunitetin, duke dhënë zgjidhje digjitale në probleme të ndryshme të identifikuar nga mësimdhënësit e tyre. Me këtë rast, nuk mund të mos e përmendim faktin që studentët e FSHK-së arritën të dizajnojnë, realizojnë dhe ta vënë në përdorim printerin 3D. Një përshkrim të kësaj teme do ta gjejmë edhe në këtë numër të revistës KODI X.

Po ashtu, viti 2017 do të mbahet mend për të gjithë gjilanasit me rrethinë, për ngjarjen e parë e cila do të jetë e përvjetshme dhe gjithëherë madhështore - ceremonia e diplomimit të studentëve në UKZ.

Ne i ftojmë të gjithë studentët, mësimdhënësit dhe të tjerët të bashkëpunojnë me revistën KODI X, duke na dërguar artikuj të ndryshëm të cilët pas miratimit nga Këshilli Redaktues do t'i botojmë në numrat e ardhshëm!

Ju dëshirojmë lexim të këndshëm!

Prof.asoc.dr. Xhevdet Thaqi
Redaktori përgjegjës

Në këtë numër do të lexoni edhe këta artikuj:

1. Revista KODI X shënon ecjet e UKZ-së dhe FSHK-së.....	2
2. "Patrioti më i madh sot në Kosovë është studenti i dhjetësheve të merituar dhe profesori i tij".....	3
3. Ceremonia e diplomimit të studentëve të Universitetit "Kadri Zeka".....	5
4. Akreditimi i programeve të reja në UKZ vazhdoi edhe në vitin 2017.....	7
5. Akreditohen dy programe studimi Master në Universitetin "Kadri Zeka".....	8
6. Programi Master e-qeverisja, program me perspektivë evropiane i vlerësuar lartë nga Ekipi i Ekspertëve.....	9
7. Filluan studimet në programin master e-qeverisja.....	10
8. Diplomimet e para në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.....	11
9. Projekti REBUS nga programi ERASMUS+ në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.....	14
10. FSHK prezenton rezultatet e saja në Konferencën ATEE 2017 në Riga të Letonisë.....	16
11. Prezentime në Konferenca Ndërkombëtare.....	17
12. Universiteti "Kadri Zeka" shkëmben profesorë me universitetet Evropiane.....	18
13. Prezentimi i II vjetor i projekteve të FSHK.....	20
14. Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan anëtar i Fondit Evropian të Universiteteve (EUF).....	25
15. Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjilan bëhet anëtare e ENAI.....	25
16. Përshtypjet e studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike.....	26

PATRIOTI MË I MADH, SOT NË KOSOVË, ËSHTË STUDENTI I DHJETËSHEVE TË MERITUARA DHE PROFESORI I TIJ

(Fjala e rektorit me rastin e ceremonisë së diplomimit të studentëve të UKZ-së)



Katër vjet pas themelimit të Universitetit "Kadri Zeka", sot jemi mbledhur këtu të kurorëzojmë dhe të gëzojmë për të arriturat e para. Sot janë këtu me ne 130 studentë të diplomuar. Numri i përgjithshëm i të diplomuarve është 200. Këta janë studentët me fat që kanë marrë të parët diplomën e Universitetit në Gjiilan, me emrin e njërit prej heronjve të Kosovës, dijetarit dhe trimit të madh, "Kadri Zeka".

Sot nuk janë të gjithë këtu. Disa kanë filluar punën sapo kanë marrë diplomën dhe gëzohemi që mungojnë dhe u urojmë sukses në karrierën e tyre. Një numër prej këtyre të diplomuarve kanë regjistruar me sukses studimet master në UKZ dhe në Universitetin e Prishtinës.

Vjet takova dy studentët tanë, të cilët në kuadër të mobilitetit të studentëve kanë kryer një vit studimi në Universitetin e Paderbonit në Gjermani. I pyeta se çka u kishte bërë më së shumti përshtypje? Ata më thanë: jemi të lumtur dhe të befasisur se studimet në Gjermani nuk dallojnë shumë nga studimet në UKZ: ligjëratat, ushtrimet, provimet, praktika, notimi, bashkëpunimi student-profesor etj., në UKZ janë të afërta ose të njëjta me ato të universiteteve evropiane. Kur ma thanë këtë, ata ndjeheshin të lumtur me të arriturat e universitetit tonë dhe të vendit tonë.

Më bënë edhe mua krenarë, sepse shihja te ata njerëzit e suksesshëm por edhe patriotët e vërtetë. Patrioti më i madh sot në Kosovë është studenti i dhjetësheve të merituar dhe profesori i tij.

Dua të veçoj disa prej të arriturave të studentëve tanë. Studentët tanë, krahas mësimit, kanë realizuar disa projekte ndërlidhura me tregun e punës dhe me punë konkrete: kanë prezantuar hulumtimin me temë: "Niveli i të bërit

konkurrencë në rajonin e Gjiilanit"; hulumtimin "Pandershmëria akademike – kopjimi", në kuadër të Programit "Digjitalizimi dhe komuniteti", studentët e FSHK kanë realizuar disa projekte lokale: a. DigitalBuss, WebSchcool Gjiilan, Aplikacioni për Kontabilitet, Aplikacioni për maxhimin e pagesave etj.

Unë prezantova në fund të vitit të kaluar në diplomimin e studentit të parë në Fakultetin Ekonomik. Kam një përvojë dhjetëvjeçare në mbrojtjen e temave të diplomës dhe mund të them se ajo mbrojtje ishte e shkëlqyeshme, për cilindo universitet. Studentët tanë kudo që kanë shkuar, janë dalluar për së miri.

Studentët tanë nga UKZ këtë vit kanë marrë pjesë në Konferencën Rinore – Shkollën Verore për studentët dhe profesorët, organizuar nga Universiteti "Aristotel" në Selanik të Greqisë, Rrjetit të Universiteteve të Detit të Zi (BSUN) dhe Shoqatës së Universitetit të Ballkanit (BUA); kanë prezantuar rininë e Kosovës në Samitin e Paqes në Seul të Koresë; janë emëruar ambasadorë të Organizatës Ndërkombëtare "Youth Time" me seli në Pragë të Çekisë; kanë përfituar bursa nga projektet tona me Erasmus+ dhe kanë kryer studime, si në Universitetin e Paderbonit në Gjermani, Lubjanës në Slloveni, atë të Splitit në Kroaci, të Leonit në Spanjë, në Katovicë të Polonisë, në Sofje të Bullgarisë; edhe në UKZ janë realizuar disa vizita studimore në kuadër të Erasmus+, apo edhe në kuadër të marrëveshjeve bilaterale me partnerët tanë, si ajo e Universitetit Zug në Zvicër dhe atë të Mariborit në Slloveni. Me këto aktivitete, UKZ po ua hapë derën partnerëve ndërkombëtar, ngadalë por sigurt.



Tregimi për Kullën e Ajfelit

Kur lexova për herë të parë për printerët 3D u gëzova për këtë zbulim, por edhe u shqetësova. Një printer 3D mund ta zëvendësojë një fabrikë. Gjithçka që mund të vizatosh në kompjuter, mund ta printosh me çfarëdo materiali. Kur e kam lexuar këtë, as që më ka shkuar ndërmend se, vetëm një a dy vjet më vonë, studentët e Universitetit “Kadri Zeka”, me forca të veta do të blejnë pjesët dhe do ta konstruktojnë printerin 3D. Para një muaji, studentët tanë kanë filluar të printojnë elementet e para në 3D.

Kulla e Ajfelit që po e mbaj në dorë, është artefakt i printuar në printerin 3D në universitetin tonë. Kështu, UKZ po hyn ngadalë, por sigurt në ekonominë dhe në tregun e vendit.

Qëllimi i universitetit nuk është t'i bëjë studentët vetëm të memorizojnë informata dhe të dhëna, por të mendojnë në mënyrë kritike dhe të përgatiten për tregun e punës.

Nuk dua të krijoj përshtypjen se gjithçka shkëlqen në UKZ. Ne kemi vështirësi, madje tepër shumë vështirësi: nuk kemi hapësirat e nevojshme, nuk kemi numër të duhur të stafit akademik, nuk kemi laboratorë të mjaftueshëm, buxheti tepër i vogël etj.

Pavarësisht prej vështirësive, një gjë dua t'i sigurojë familjarët, institucionet dhe gjithë shoqërinë: në UKZ bijat dhe

bijtë tuaj kanë gjetur rrugën e duhur dhe të sigurt për të ecur përpara, për ta ndërtuar karrierën e tyre. Risi në këtë proces janë programet multidisiplinare të masterit, të cilat janë në hap me zhvillimet moderne të universiteteve evropiane.

Në planin e hulumtimit dhe të bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar, UKZ është pjesë e tri projekteve të Erasmus+: Projekti REBUS, Projekti EUFORIA, GREEN TECH dhe një projekti Kosovë-Austri- projekti HERAS. Është themelues dhe anëtar i Asociacionit të Universiteteve të Ballkanit (BUA), dhe anëtar i Asociacionit të Mësimdhënësve Evropianë (ATEE).

Tash, për pak minuta do të fillojë ceremonia e ndarje së diplomave. Ky është momenti më i pritur dhe më i dashur për studentët, për familjarët dhe për të gjithë neve. Për herë të parë në Gjilan, Universiteti “Kadri Zeka” ndanë diplomat për studentët e vet. Për herë të parë studentët në këtë sallë do të hedhin kapelat e studentëve, një simbol i njohur universitar në shenjë të përfundimit të studimeve. Të dashur studentë, ju do të vazhdoni tutje, kush në nivele të tjera studimore, kush në punë. Ne do të interesohemi për ju edhe më tej dhe do të jemi përkrahësit tuaj.

Urime dhe ju priftë e mbara!



CEREMONIA E DIPLOMIT TË STUDENTËVE TË UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA"



Ceremonia e diplomimit të studentëve të UKZ-së

Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan, i udhëhequr nga rektori Bajram Kosumi, më 27 tetor 2018, ka organizuar ngjarjen më të madhe e të rëndësishme për studentët dhe gjithë rajonin e Gjilanit - ceremoninë e diplomimit të studentëve.



Fillimisht, studentët e diplomuar të veshur me uniformën solemne, të prirur nga dekanët e tyre, ai i Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Ekonomik, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, kanë parakaluar në sallë në prani të mysafirëve që ishin të shumtë, për të vazhduar në tribunën kryesore.

Pastaj, po ashtu, solemnisht kanë filluar t'i zënë vendet e tyre edhe rektori, prorektorët dhe sekretari i përgjithshëm.

Më pas nën përcjelljen e korit, është bërë intonimi i himnit të Kosovës, ai kombëtar dhe ai i universitetit.

Rreth punës, sukseseve, të arriturve dhe sfidat që e kanë përcjellë ose që i ka edhe sot Universiteti "Kadri Zeka", ka folur rektori Bajram Kosumi.

Ai ka falënderuar studentët, stafin akademik e administrativ dhe të gjithë të pranishmit për punën dhe angazhimin e treguar në fusha të ndryshme në të mirën e Universitetit në përgjithësi.

Rektori ka thënë se katër vjet mbas themelimit të Universitetit "Kadri Zeka", sot jemi mbledhur këtu të kurorëzojmë dhe të gëzojmë për të arriturat e para. "Sot janë këtu me ne 130 studentë të diplomuar. Numri i përgjithshëm i të diplomuarve është 200. Këta janë studentët me fat që kanë marrë të parët diplomën e Universitetit në Gjilan, me emrin e njërit prej heronjve të Kosovës, dijetarit dhe trimit të madh, Kadri Zeka".



Rектори në fjalën e tij ka thënë se “studentët tanë janë model i studentit në nivel të Kosovës, janë të barabartë me studentët në Evropë dhe kjo na bënë shumë krenar, karshi edhe sukseseve të treguara në fusha të ndryshme në të gjitha drejtimet që ka Universiteti “Kadri Zeka”. Jemi të përkushtuar për të ecur përpara me program të qartë të zhvillimit të institucionit tonë dhe këtë do ta arrijmë së bashku. Niveli i studentëve që kemi, niveli i stafit akademik, na bënë të jemi më afër synimeve tona për zhvillim dhe suksese në të ardhmen”.

Në këtë manifestim, morën pjesë dhe e madhështuan edhe strukturat e komunave të Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë. Në fjalën e tij kryetari i komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ka thënë se studentët e Universitetit “Kadri Zeka”, i japin fuqinë akademike, arsimore dhe kulturore dhe Gjilanin e bëjnë qendrën më të fuqishme në rajonin e juglindjes së Kosovës. Në Universitetin “Kadri Zeka”, nuk janë vetëm gjilanasit dhe Anamorava, por edhe studentët tanë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, Kumanova. Besoj shumë se ky universitet do të ketë një shtrirje më të gjerë dhe do të bëhet edhe më atraktiv për të gjithë studentët që jetojnë kudo në trevat shqiptare. Është universitet që ka studim dhe studentët e tij janë të barabartë me studentët kudo në Evropë.

Në emër të deputetëve të Kuvendit të Kosovës nga Anamorava, me një fjalë përshëndetëse është paraqitur deputeti Ahmet Isufi. Ai ka thënë se ndihet jashtëzakonisht krenar me gjithë këta studentë të ndritur, të cilët do të jenë nesër të gatshëm t’i shërbejnë më së miri vendit të tyre, Kosovës.

Ndërsa në emër të gjithë studentëve të pranishmit i ka përshëndetur kryetarin e Parlamentit të Studentëve, Adrian Bajrami, i cili po ashtu është pjesë e studentëve të diplomuar të UKZ-së.

Ai ka thënë se është kënaqësi dhe ndjenjë e veçantë, por gjithashtu përgjegjësi e lartë që sot t’u drejtohet në cilësinë e Parlamentit të Studentëve dhe rinisë studentore si dy shtylla të përfaqësimit studentor që gjithnjë



ishin aty kur ishte interesi i universitetit, ishin aty kur dëgjohej zëri i studentëve.

“Sot, jemi këtu duke përmbyllur një pjesë më të rëndësishme të jetës sonë, pra studimet, periudhë kjo e cila na dha formë si profesionist të së ardhmes, që çdo ditë na dha emocione të veçanta çka vetëm jeta studentore të benë t’i përjetosh”.

Ai ka porositur të diplomuarit që mos ta konsiderojnë këtë ditë të sotme si finish, por ta konsiderojnë si start, sepse gjithë jeta jonë është një rrugëtim pa fund drejt dijes.

Në vazhdim, solistja Elona Sadiku, ka interpretuar këngën: “Rrjedhë në këngë e ligjërime”, në përcjelljen e Prof. Hekuran Bllaca

Pastaj rektori Bajram Kosumi, ka ndarë diplomat për studentët e diplomuar që kanë qenë të dalluar në mësim, dhe për ata studentë të cilët para se të diplomojnë kanë qenë pjesë e programit ERASMUS +.

Edhe Zenun Pajaziti, përfaqësues i familjes së atdhetarit Kadri Zeka, emrin e të cilit e mban universiteti ynë, u ka ndarë diploma disa studentëve.

Më pas secili dekan, veç e veç, ka ndarë diplomat për secilin studentë të diplomuar.

Krejt në fund u realizua edhe momenti më kryesor, hedhja e kapelave nga studentët e diplomuar.



AKREDITIMI I PROGRAMEVE TË REJA NË UKZ VAZHDOI EDHE NË VITIN 2017



Nga takimi i menaxhmentit të UKZ-së me ekipin e ekspertëve të AKA-së

Në kuadër të procesit të akreditimit të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, të shoqëruar nga përfaqësuesit e Agjencionit për Akreditim të Kosovës kanë zhvilluar takim pune me menxhmentin e universitetit, stafin akademik dhe studentët e UKZ-së, në kuadër të vlerësimit të akreditimit të programeve të cilat janë në proces të akreditimit. Me këtë rast rektori i Universitetit “Kadri Zeka”, Bajam Kosumi tha se kemi zhvilluar një takim të frytshëm me ekspertët ndërkombëtarë, sepse ka kohë që kemi filluar përgatitjet për këtë proces, andaj presim që gjithçka të shkoj mirë.

Grupi i ekspertëve për akreditim, që përbëhej nga prof.dr. Volker Gehmlich nga Universiteti i Osnabrut, prof. dr. Volker Frederking nga Universiteti i Nürnbergut, prof. Stephen Adam nga Universiteti “Westminster”, prof. dr. Tauno Otto nga Universiteti i Talinit dhe prof. dr. Regita Bendikiene nga Universiteti i Kaunasit, pas takimit me menaxh-

mentin kanë vizituar hapësirat ku zhvillohet puna me studentët, laboratorët dhe kabinetet ku kryhet puna praktike.

Më pas ekspertët e akreditimit kanë mbajtur takime veç e veç me bartësit e programeve për akreditim, e riakreditim, ndërkohë kanë takuar edhe pjesën tjetër të stafit akademik gjithashtu edhe studentët. Ky proces ka të bëjë me akreditimin e Universitetit si institucion dhe programeve që ofrohen në kuadër të tij.

Universiteti “Kadri Zeka” ka bërë kërkesë për riakreditim të dy programeve të nivelit Bachelor: Marketing dhe Banka Financa Kontabilitet, kurse për akreditimit janë tri programe të reja Master: Edukimi Special, Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike dhe programin E-Qeverisja, po ashtu universiteti ka aplikuar edhe për riakreditim institucional.

AKREDITOHEN DY PROGRAME STUDIMI MASTER NË UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA"

Në mbledhjen e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) së Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) më 23.6.2017, u shqyrtuan raportet e vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit dhe riakreditimit institucional dhe të programeve të studimit në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë.

Pas shqyrtimit dhe analizës së këtyre raporteve Universiteti "Kadri Zeka" u riakreditua si Institucion publik i arsimit të lartë për periudhën e ardhshme trivjeçare, duke plotësuar standardet dhe kriteret e vlerësimit dhe akreditimit.

Në këtë mbledhje të KSHC u akredituan edhe dy programe master në UKZ për periudhën trivjeçare: programi Master e-qeverisja dhe

programi Master Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike.

Programi master E-qeverisja është program i përbahket i Fakultetit të Shkencave Komputerike, Fakultetit Juridik dhe Fakultetit Ekonomik të UKZ-së. Programi i Qeverisja Lokale dhe Shoqëria Demokratike është program i përbashkët i Universitetit "Kadri Zeka", Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë dhe "Ukshin Hoti" në Prizren.

Po ashtu, nga AKA janë riakredituar edhe dy programe bachelor të fakultetit ekonomik: Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe programin Marketing.



Stafi i UKZ-së me ekipin e Ekspertëve të AKA-së

PROGRAMI MASTER E-QEVERISJA, PROGRAM ME PERSPEKTIVË EVROPIANE, I VLERËSUAR LART NGA EKIPI I EKSPERTËVE

Si në tërë Evropën ashtu edhe në Kosovë e-qeverisja po zë vend gjithnjë e më shumë në të gjitha nivelet e administratës shtetërore dhe private. Kjo po paraqet zgjidhje të reja të sfidave qeverisëse të cilat po dëshmojnë faktin se e-qeverisja është një nga tregimet e suksesshme të Evropës në dekadën e fundit. Fakulteti i Shkencave Kompjuterike në bashkëpunim me Fakultetin Juridik ka marrë një hap me qëllim që rajonit, Kosovës dhe më gjerë t'i sigurojë kuadra të cilët lehtësisht do të përcjellin të arrituarat e kësaj fushe të re dhe të kohës duke zbatuar teknologji informative dhe kompjuterike në nivele të ndryshme të administratës, si të sektorit publik, ashtu edhe privat, duke përgatitur këtë program master të quajtur E-Qeverisja.

Programi do të mbështetet në zgjidhjet e IT në nivel qeveritar, në bashkëpunim me Fakultetin Juridik të Universitetit "Kadri Zeka" dhe do të përfshijë sfond themelor (ligji, të menaxhimit publik dhe IT) edhe në aspekte të tjera të qeverisjes.

Programi është veçanërisht i rëndësishme për shkak të arsyes që është unik në Kosovë dhe kërkesa për specialist me njohuri të gjerë të e-qeverisjes është në rritje të jashtëzakonshme.

Programi i Master në E-Qeverisje do t'iu ofrojë studentëve njohuri të gjera për ndërtimin e një shteti modern - kalimin në e-qeverisje, menaxhimin dhe zhvillimin të tij. Studimet përfshijnë një pasqyrë të gjerë të aspekteve administrative dhe ligjore të e-qeverisjes.

Gjatë 2 viteve (4 semestrave) të studimeve programi zhvillon kurse me orientim më specifik në fushën e – qeverisjes me qëllim të arrihet:

- Aftësimi në zbatimin e TIK për të zhvilluar shërbime të e-qeverisjes në një administratë më transparente dhe të përgjegjshme, të sigurojë pjesëmarrje më efektive për qytetarët si dhe sigurimin e instrumenteve të politikave të marrin vendime më të informuara.
- Aftësimi në zbatimin e TIK në kryerjen e detyrave të ndryshme administrative më efektive dhe efikase.
- Aftësimi i krijimit të strukturave dhe shërbimeve, duke i ndërlidhë aspektet organizative, kompjuteristike dhe ligjore.
- Aftësimin për të mbledhur, ruajtur dhe përpunuar informatat e nevojshme në një sfond i cili shërben për vendimmarrje të nevojshme dhe efektive me anë të TIK-ut.
- Aftësimi për të identifikuar, analizuar, përpunuar dhe zbatuar në ndërvarësitë dhe ndërlidhjen e TIK me qeverisje.

Komform misionit të universitetit (UKZ), misioni i këtij programi studimor është të promovojë studimin e shkencave kompjuterike, shkencave administrative dhe juridike, duke u bazuar në vlerat evropiane (Procesin e Bolonjës) programeve studimore dhe përvojës së tyre.

Ky programë është garancion që studentët tanë do të jenë specialistë në fushën e e-qeverisjes.

Ky program përqendrohet në dizajnimin, zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve qeveritare dhe zbatimin e kom-

ponentëve të e-qeverisjes në çdo nivel të administratës publike dhe shtetërore. Do të fokusohet në specializim në teknologjitë IT, inovacion të shërbimeve në sektorin publik dhe privat ose miratimit dhe tregtimin e e-qeverisjes, në ofrimin e aftësimit të kryerjes së shërbimeve administrative, menaxhuese, dhe ruajtjes së të dhënave, duke u bazuar në teknologji informative dhe të komunikimit.

Programi ofron po ashtu eksperiencë në institucione të ndryshme, hulumtim praktik në kuadër të projekteve gjatë studimeve, si dhe duke organizuar laboratorin "teknologjitë e e-qeverisjes".

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike, në pajtim me planin e studimeve, përdorë një kombinim të aspekteve teorike dhe praktike mësimore. Shumica e ligjëratave janë të përbëra nga pjesa teorike, si dhe pjesa praktike që mbahet në laboratorët tanë. Studentët janë të rekomanduar që me përfundimin e studimeve të vitit të parë akademik të aplikojnë për përvojat praktike të fushës e e-qeverisjes në institucione dhe organizata (ose të zgjedhur një projekt në semestrin e tretë) në kuadër të hulumtimit, e cila vlerësohet me notë dhe ECTS. Temat e zgjedhura janë janë relevante për implementimin e njohurive teorike në ato praktike duke kontribuar në përmirësimin e administratës në nivele të ndryshme horizontale dhe vertikale. Pjesa praktike konsiderohet shtylla kryesore e programit, e cila realizohet në kuadër të semestrit III dhe IV. Në semestrin V realizohet në kuadër të hulumtimit i cili nënkupton një projekt hulumtues i cili vlerësohet me 12 ECTS dhe konsiston në aplikimin e njohurive teorike të fituara në kurset paraprake në zgjidhjen e problemeve të caktuara praktike të cilat identifikohen në insitucione apo ndërmarrje të ndryshme me të cilat UKZ ka bashkëpunim. Në këtë mënyrë, shohim edhe motivimin e studentëve për arritje më të mëdha, dhe arsyeshmërinë e funksionimit të programit studimor. Pjesa praktike po ashtu arinë të thellohet edhe më shumë në kuadër të punimit të diplomës e cila do të realizohet me zgjidhjen e problemeve të caktuara në insitucione apo kompanitë bashkëpunuese të UKZ. Punimi i diplomës përfshin 30 ECTS të cilat drejtpërdrejt realizohen në pjesën praktike të programit studimor.

Në këtë program kanë të drejtë të aplikojnë për regjistrim të gjithë studentët të cilët kanë të kryer nivelin Ba (ose ekuivalent me të) nga fusha e shkencave juridike, administratës publike, shkencave kompjuterike, shkencave ekonomike dhe programeve të tjera, të cilat përcaktohen me kushte të veçanta nga Fakulteti i Shkencave Kompjuterike.

Në semestrin e parë për studentët e Shkencave Kompjuterike, Inxhinierisë Kompjuterike dhe Informatikës do të organizohen kurse nga shkencat juridike- administrative, ndërsa për studentët e shkencave ekonomike do të organizohen kurse nga shkencat kompjuterike dhe juridike administrative. Studentët të cilët regjistrohen nga fakultetet të cilat kanë mungesë të aftësive të punës me kompjuterë do të kenë lëndë specifike zgjedhore me qëllim të arritjes së njohurive nga kompjuterizmi për t'u aftësuar dhe vazhduar studimet.

FILLUAN STUDIMET NË PROGRAMIN MASTER E-QEVERISJA

Në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjiilan, është mbajtur provimi pranues për studimet master, respektivisht për programin E-qeverisja.

Menaxhmenti ka organizuar dhe realizuar procesin e pranimit të studentëve të rinj duke percjellë nga afër gjithë këtë proces, ku fillimisht studentëve iu kanë dëshiruar suksese dhe janë shprehur të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimit pranues.

Universiteti “Kadri Zeka” në Gjiilan për studime master ofron dy programe studimi për studentët e rinj për vitin akademik 2017-2018

Në programin E-Qeverisja, program ky i përbashkët mes Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit “Kadri Zeka”. Në këtë program UKZ do të regjistrojë 60 studentë të rregullt, ku përfshihen edhe studentë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja, si dhe nga komunitetet joshumicë.

Studentët e pranuar do të ndjekin këto kurse:

Në semestrin I, lëndët:

- Shteti dhe qeverisja,
- Menaxhimi dhe ruajtja e informacioneve,
- Parimet e sistemeve informative,
- Kompjuteristikë,
- Statistikë për e-qeverisje,
- Qeverisja e korporatave*,
- Sistemet virtuale,
- Informatika sociale,
- Menaxhimi dhe e-qeverisja,
- Qeverisja e korporatave,

Në semestrin II, lëndët:

- Programimi dhe e-qeverisja,
- Databaza për e-qeverisje,
- Menaxhimi publik dhe administrimi,
- Menxhimi i sistemit të informacionit (MSI),
- Zhvillimet në Cloud,
- Planifikimi dhe implementimi i e-qeverisjes,

- Rregullimi ligjor i databazave,
- Etika profesionale në qeverisje,
- Rregullimi ligjor i databazave

Në semestrin III, lëndët:

- Siguria nga Krimet kibernetike,
- Arkivimi dixhital dhe sistemet e informimit,
- Programet aplikative në e-qeverisje,
- Projekti hulumtues (për Informatikë),
- Projekti hulumtues (për Ekonomi),
- Projekti hulumtues (për Juridik)

Në semestrin IV:

- Punimi i diplomës

Varësisht nga studimet baçelor, studentët kanë lëndët zgjedhore të nevojshme për arritjen e objektivave të programit studimor.

Pas diplomimit kandidatët marrin titullin Msc i E-Qeverisjes.




DIPLOMIMET E PARA NË FAKULTETIN E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE


Në kuadër të punimit të diplomës në vitin akademik 2016/2017, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjiilan, mësimdhënësja Dr. Lindita Nebiu-Hyseni udhëheqi tre studentë me tema të ndryshme. Studentin Jeton Selimi me temën "Krijimi i website-it për barnatore", studenten Djelleza Rustemi me temën "Krijimi i website-it për produkte të fitnesit", si dhe studenten Nuriye Haliti me temën "Krijimi i website-it për autosallon". Websitet e krijuar nga studentët në kuadër të punimit të diplomës janë dinamikë pasi që përmbajnë modulën e administrimit të të dhënave. Kjo nënkuton se çdo e dhënë që regjistrohet nëpërmjet këtij moduli paraqitet në mënyrë automatike në website pa pasur nevojë të intervenohet në kod burimor nga profesionistë të fushës së web teknologjisë. Ky modul mundëson që me shumë lehtësi të implementohet dhe përdoret website-i nga përdorues të thjeshtë që nuk i takojnë fushës së Web Teknologjisë.

Tema e diplomës "Krijimi i website-it për barnatore" e punuar nga studenti Jeton Selimi është e fokusuar në krijimin, dizajnimin dhe menaxhimin e website-it për barnatore. Website-i i krijuar dhe dizajnuar përmban informata rreth produkteve, përkatësisht vajërave që gjenden dhe shiten në barnatore, lajme rreth produkteve dhe porosisë së tyre online nga klientët pavarësisht pozitës së tyre gjeografike. Menaxhimi i website-it bëhet në mënyrë dinamike për shkak se janë përdorur gjuhët në vijim për krijim të tij: HTML, CSS, JavaScript, JQuery, PHP. Si dhe është përdorur sistemi i bazës së të dhënave MySQL. Sipas hulumtimit të bërë në website të ndryshme në internet, pak prej tyre ofrojnë mundësinë e porosisë së produkteve online përmes internetit dhe nuk ofrojnë përshkrim të detajuar të produkteve gjithashtu nuk përmbajnë meny të veçantë të porosisë së tyre në website në mënyrë që përdoruesit të mos humbin kohë dhe të mos mërziten gjatë kërkimit të produkteve që ata i kërkojnë.


Dizajni është pjesa kryesore e një website të krijuar sepse tërheq klientët për përdorim të tij, prandaj i është kushtuar shumë rëndësi dizajnit. Në figurat në vijim është paraqitur dizajni i disa faqeve të website-it dhe modulit të administrimit të të dhënave.




Ballina e website-it për barnatore



Forma e plotësimit për porositë e produkteve



Ballina e modulit të administrimit




Ballina e website-it për autosallon "SEVI SWISS"

Tema e diplomës “Krijimi i website-it për auto sallon” e punuar nga studentja Nurije Haliti është e fokusuar në krijimin e website-it për autosallon në mënyrë që përdoruesit të informohen mbi shërbimet dhe veturat që ofrohen në autosallonin SEVI SWISS, i cili operon në Zvicër. Gjithashtu website-i ofron informata mbi ekipin, i cili punon në këtë sallon dhe e cila do të mund të menaxhojë të dhënat që paraqiten në këtë website. Website-i është krijuar duke përdorur gjuhët në vijim: PHP, MySQL, HTML, CSS, JavaScript, JQuery. Këto gjuhë mundësojnë që website-i të menaxhohet në mënyrë dinamike që nënkupton se të gjitha të dhënat që paraqiten në website lehtësisht mund të azhurnohen, shtohen apo edhe fshihen edhe nga personat pa përvojë në fushën e teknologjisë informative, mjafton vetëm një trajnim njëditori i stafit.



Paraqitja e të dhënave të veturës



Ballina e modulit të administrimit

Duke marrë parasysh se jetojmë në një kohë ku teknologjia ka pushtuar botën dhe si pasojë çdo gjë po shkon drejt digjitalizimit, krijimi i website-it për auto sallonin SEVI SWISS do të ndihmojë kompaninë për të informuar klientët mbi shërbimet që ofron. Website përmban një dizajn të përshtatshëm dhe funksional për të gjithë klientët pa dallim moshe. Gjithashtu, website është dinamik, shkaku se mundëson administrimin e të gjitha të dhënave që paraqiten tek klientet. Pas hulumtimit të bërë për website-at aktual që ofrohen në internet për autosallone dhe pas kërkesave të kompanisë SEVI SWISS, website-i për auto sallon i krijuar në kuadër të punimit të diplomës përmbanë këto mënyra: “Home”, “Services”, “Cars”, “Our Team”, “Contact”. Në figurat në vijim është paraqitur dizajni i disa faqeve të website-it dhe modulit të administrimit të të dhënave.

Studentët e FSHK-së të diplomuar në 2017

Nr.r.	Tema e diplomës	Kandidati	Komisioni	Data
1.	Evidenca Kontabël e TVSH-se përmes softuerit aplikativ	Besa Mustafa	1.Prof.ass.Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar , 2. Prof.asoc.Dr. Xhevdet Thaqi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Shefket Jakupi-Mentor	07.07.2017
2.	Implementimi i kontabilitetit përmes softuerit aplikativ në ndërmarrjen JETA	Nitë Gashi	1.Prof.ass.Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar , 2. Prof.asoc.Dr. Xhevdet Thaqi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Shefket Jakupi-Mentor	07.07.2017
3.	Deklarimi i kontributeve dhe tatimeve përmes sistemit elektronik (EDI)	Elion Neziri	1.Prof.ass.Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar , 2. Prof.asoc.Dr. Xhevdet Thaqi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Shefket Jakupi-Mentor	07.07.2017
4.	Krijimi i website-it për barnatore	Jeton Selimi	1 .Prof.Ass.Dr.Ragmi Mustafa-Kryetar 2. Prof.Asoc.Dr. Xhevdet Thaqi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	07.07.2017
5.	Krijimi i website-it të shkollës "Thimi Mitko"	Fortesa Vranja	1. Prof.Ass.Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar 2. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	14.07.2017
6.	Siguria kibernetike për qytetarët e Republikës së Kosovës	Edonis Hashani	1. Prof. Ass. Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar 2. Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Mentor	14.07.2017
7.	WEB aplikacioni per krijimin e CV Komisioni.	Rion Halili	1.Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi- Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Mentor	:03.10.2017
8.	Përdorimi i "Framework-ut" Laravel në WEB – aplikacioni "Orari"	Arlind Kryeziu	1.Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi- Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Mentor	03.10.2017
9.	Inxhinierimi Softwerik për proejktin "ORARI"	Floim Asani	1.Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi- Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Mentor	03.10.2017
10.	Biblioteka Online	Buen Bajrami	1.Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Mentor	06.10.2017
11.	Përdorimi i Algoritmeve Gjenetika në gjenerimin e orarit	Arlind Hajdari	1. Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Artan Dërmaku-Mentor	06.10.2017
12.	Krijimi dhe implementimi i printerit 3D	Ardit Halimi	1. Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3. Prof. Ass. Dr. Xhevahir Bajrami-Mentor	07.10.2017
13.	Krijimi i një aplikacioni për motin në platforma iOS	Fatjona Sylejmani	1.Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Artan dërmaku-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	:09.10.2017
14.	Krijimi i website-it për produkte të fitnesit.	Djellza Rustemi	1.Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Artan dërmaku-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	09.10.2017
15.	Krijimi i aplikacioneve për gjetjen e pakove në iOS.	Alanda Sylja	1.Prof. Asoc. Dr. Ragmi Mustafa-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Artan dërmaku-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	09.10.2017
16.	Krijimi dhe mënyra e hostimit të një Website-it për shkolla	. Yllka Emini	1.Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	09.10.2017
17.	Krijimi i aplikacionit për pagesa në kafe-restoran	Vildan Asllani	1.Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	:09.10.2017
18.	Krijimi i website-it për restoran	Dren Sylejmani	1.Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	09.10.2017
19.	Disa përparësi të teknologjisë "CLOUD"	Eda Agushi	1.Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	09.10.2017
20.	Krijimi i website-it për Autosallon	Nurije Haliti	1.Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi-Kryetar, 2. Prof. Ass. Dr. Ekrem Halimi-Antarë 3.Prof. Ass. Dr. Basri Ahmedi-Mentor	:09.10.2017

PROJEKTI REBUS NGA PROGRAMI ERASMUS+ NË FAKULTETIN E SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Aktivitetet dhe metodologjia e Projektit REBUS



Projekti REBUS përbëhet nga shtatë paketa pune:
WP 1 Përgatitja: Hulumtimi dhe analiza e nevojave
WP 2 Zhvillimi: Qasja e të nxënit të ndërmarrësisë me kompetencë (përfshirë validimin)
WP 3 Zhvillimi: Trajnimi dhe këshillimi i stafit të HE
WP 4 Zhvillimi: Pilotimi i qasjes së bazuar në kompetencë të të mësuarit për sipërmarrjen (në vlefësimin e vlerësimit) të zhvillimeve të kompetencës, akreditimit dhe certifikimit.
WP 5 Plani i Cilësisë
WP 6 Shpërndarja dhe shfrytëzimi
WP 7 Menaxhimi

Universitetet partnere do të punojnë përgjatë një qasjeje të orientuar drejt kërkimit të veprimit në paketat e punës R & D. Në hapin e parë ata do të ulumtojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë sistemet e vlerësimit dhe validimit të të nxënit të hapur (dhe me ndihmën e TIK) në lidhje me marrjen e kompetencave kyçe në arsimin e lartë dhe praktikës së ndërmarrësisë. Rezultati do të jetë një studim në shkallë të gjerë bazuar në hulumtimet cilësore dhe sasiore që do të finalizohen në fund të vitit të parë. Rezultatet e përkohshme do të dorëzohen në muajin e 6 të realizimit të projektit. Në këtë mënyrë REBUS paraqet strukturë që siguron cilësi sipas sistemeve bashkëkohore si ISO ose EFQM.

Në kuadër të vlerësimit të produktit dhe programit të REBUS-it, instrumentet e produkteve të saj do të vlerësohen sipas kriterëve specifike të miratuara nga partnerëti dhe në fund të transferuara në nivele të ndryshme si:

- në modulet inovative të mësimit dhe mjediset e hapura të të nxënit në arsimin e lartë universitar
- në modulet inovative të mësimit dhe validimit të ndërmarrje.
- në skemat e reja të validimit dhe akreditimit dhe

kombinimit të validimit formal dhe joformal (ECTS, EQF, LEVEL5, EUROPASS).

Do të ketë disa detyra të lidhura me përmbajtjen dhe menaxhimin e projekteve administrative. Hapat kryesorë të projektit do të kufizohen nga momentet e projektit në formën e 3 takimeve transnacionale.

Në strukturën e strukturës së punës (WBS) objektivat operacionale të parashikuara do të përcaktojnë produktet dhe aktivitetet përkatëse për secilën partner. Rezultatet do të vlerësohen sipas treguesve objektivisht të verifikueshëm (OVI). OVI do të vlerësohen gjatë takimeve me partnerët dhe pastaj do të përpunohen dhe përshtaten për periudhën e ardhshme të vlerësimit.

Qëllimet dhe objektivat e projektit REBUS



Shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Rusia, si vende me trashëgëmi nga sistemi politik me ekonomi centraliste në tranzicion drejt shteteve me ekonomi të tregut, kanë një nivel të lartë të rezistencës ndaj iniciativave private dhe ndërmarrësisë. Partnerët e BE do të japin mbështetje të fuqishme për të adresuar një sfidë për të sjellë ndërmarrësi, duke krijuar gjithashtu një rrjet bashkëpunimi të vendeve të BE dhe partneritet.

Modulet e trajnimit dhe sistemi i validimit mbi kompetencat e ndërmarrësisë do të rrisin tregun e punës.

Objektivat specifike të projektit REBUS janë:

Zhvillimi i një sërë formash të ndryshme të moduleve inovative të trajnimit për ndërmarrësi, të integruar në punë, të integrohen modulet në kurrikulat ekzistuese


Krijimi i një sistemi për validimin e zhvillimit të kompetencës së ndërmarrësisë.

Trajnimi i personelit të arsimit të lartë në mësimdhënien e ndërmarrësisë inovative.

Zbatimi dhe vlerësimi i moduleve të trajnimit dhe sistemit të validimit në vendet partnere.

Krijimi i sistemit për nxitjen e nxënësve në orientimin e ndërmarrësisë

Prioritetet e Projektit REBUS



Projekti synon të mbështesë zhvillimin e kompetencave kyçe për punësueshmërinë që do të garantojë më shumë fleksibilitet në forcën e punës dhe do të lejojë që të përshtatet më shpejt me ndryshimet e vazhdueshme në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar dhe komplekse. Ndërmarrja parashikohet si faktor kryesor në inovacionin, produktivitetin dhe konkurrencën dhe modulet e trajnimit të ndërmarrësisë dhe sistemi i validimit të kompetencave do të pilotohen, vlerësohen dhe integrohen në kurrikulat ekzistuese në programet e TIK dhe programet e studimeve inxhinierike.

Rritja e kompetencës së ndërmarrësisë dhe qëndrimeve sipërmarrëse të të diplomuarve të TIK dhe inxhinierisë në Ballkanin Perëndimor dhe Rusinë do të mbështesin rritjen e punësimit dhe përmirësimin e zhvillimit të këtyre vendeve si ndikim të përgjithshëm të projektit. Universitetet do të ndërtojnë qëndrime pozitive të studentëve ndaj zhvillimit të kompetencave të biznesit dhe sipërmarrjes dhe do të aftësohen për të planifikuar, filluar dhe menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme një biznes.

Përmbledhje e Projektit



Integrimi dhe validimi i aftësive praktike të ndërmarrësisë në inxhinieri dhe studime të TIK

Spektori i biznesit evropian i kushton një vëmendje gjithnjë e më të madhe kompetencave të tilla si ndjenja e iniciativës dhe sipërmarrjes.

Rekomandimi 2006/962 / EC mbi kompetencat kyçe për të mësuarit gjatë gjithë jetës thekson rëndësinë kryesore të këtyre kompetencave kyçe për punësueshmërinë. Këto kompetenca që lidhen me ndërmarrësinë luajnë një rol të madh në vendet fqinje të BE-së në procesin e tyre të zhvillimit drejt ekonomive të tregut me performancë më të lartë dhe konvergjencës me standardet ekonomike dhe sociale të BE-së. Punëdhënësit e tyre i humbasin

këto kompetenca në të diplomuarit, veçanërisht nga TIK dhe inxhinieri. Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Rusia në përgjithësi kanë një nivel të lartë të rezistencës ndaj iniciativave private, biznesit dhe sipërmarrjes. Shumë nga të rinjtë preferojnë punësim "të sigurt" në ndërmarrjet publike, vetëdijësimi dhe vlerësimi i potencialeve të ndërmarrësisë vetanake është i ulët. Projekti ka për qëllim zhvillimin, testimin, validimin dhe përfshirjen e moduleve të hapura të të mësuarit holistik dhe nevojave të nxitura për të nxitur kompetencat e ndërmarrësisë së TIK-ut në arsimin akademik dhe të të nxëniet në praktikë në kontekstet e biznesit. Niveli i kompetencës së të diplomuarve në vendet partnere pjesëmarrëse do të hulumtohet dhe identifikohen nevojat rajonale të trajnimit; do të zhvillohen trajnime modulare, praktike të sipërmarrjes; sistemi i vlefshmërisë që përfshin një komplet të përshkrimit të kompetencave të ndërlidhura me sipërmarrjen, sistemet referuese të lidhura me kontekstin për të vlerësuar dhe dëshmuar këto kompetenca, dhe do të krijohet një sistem vlerësimi dhe validimi online bazuar në qasjen e provuar dhe të testuar të Nivelit 5; do të bëhet lidhja e këtij sistemi vlerësimi dhe validimi me sistemet e validimit formal dhe të akreditimit (ECTS) dhe sistemet e certifikimit (EUROPASS) për të lejuar shfrytëzimin ndërkombëtar të kompetencave të fituara; modulet e trajnimit të ndërmarrësisë dhe sistemi i validimit të kompetencave do të pilotohen, vlerësohen dhe integrohen në kurrikulat ekzistuese në programet e TIK dhe inxhinierisë.

Partnerët e projektit REBUS

Projekti REBUS implementohet nga ekipi multidisiplinari i përbërë nga institucionet të cilët përfshijnë 16 entitete të përbëra nga 16 universitete dhe institute hulumtuese nga 8 shtete: Shqipëria, Austria, Bosnjë e Hercegovina, Gjermania, Italia, Kosova, mali i Zi dhe Rusia.

Koordinator i projektit:

P1: University of Sarajevo, Faculty of Mechanical Engineering, BiH

Partnerë të projektit:

P2: die Berater, Austria

P3: University FH Joanneum Gesellschaft M.B.H, Austria

P4: Blended learning institutions' cooperative, Germany

P5: University of Duisburg Essen, Germany

P6: University of Palermo, Italy

P7: University of East Sarajevo, Faculty of Mechanical Engineering, BiH

P8: European University of Tirana, Albania

P9: University of Elbasan "Aleksander Xhuvani", Albania

P10: Universum College Prishtinë, Kosovo

P11: "Kadri Zeka" University in Gjilan, Kosovo

P12: Mechanical Engineering Faculty University of Montenegro, MNE

P13: Volga State University of Technology, Russia

P14: Siberian State University of Telecommunications and Informatics, Russia.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE PREZANTON REZULTATET E VETA NGA KONFERENCA ATEE 2017




Më 12 dhe 13 maj 2017, në Riga të Letonisë u mbajt Konferenca e ATEE, anëtar me të drejta të plota i së cilës është edhe Universiteti "Kadri Zeka".

Në kuadër të konferencës u mbajt Kuvendi i Asociacionit të Mësimdhënësve të Evropës (ATEE), në të cilën u raportua për aspektet e punës së ATEE dhe u përcaktuan drejtimet zhvillimore në të ardhmen në të gjitha nivelet a arsimit në Evropë, përfshirë atë universitar. Një nga aspektet e rëndësishme në të cilën inkurojohen hulumtime për periudhën vijuese, ishte inkurajimi i përdorimit gjithnjë e më të madh të platformave digjitale në arsimin universitar.


Në kuadër të sesioneve të punës së konferencës, aktivi-

tetet shkencore dhe hulumtuese të UKZ-së u prezentuan nga ekipi i mësimdhënësve të UKZ-së në përbërje: prodekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike – prof. ass.dr. Ekrem Halimi, prof.ass.dr. Basri Ahmedi, prof. ass.dr. Ragmi Mustafa dhe ass.mr. Refik Ramadani.

Prezentimi i punës së UKZ-së u paraqit me projektin e titulluar: "The evaluation of an experience of the development of massive open online courses". Projekti i prezentuar ngjalli diskutime interesante nga pjesëmarrësit e tjerë të konferencës dhe u vlerësua lart nga pjesëmarrësit. Për më tepër shihni në linkun: <http://www.eduinf.lu.lv/pn/>.



PREZANTIME NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE



Prezantimi suksesshëm i UKZ-së në Konferencën Cloud Computing 2017 (IEEE) në Londër

Nga data 18-20 korrik 2017, në Londër të Mbretërisë së Bashkuar është mbajtur Konferenca Cloud Computing 2017 e sponsoruar nga IEEE. Në këtë konferencë prezantuan me sukses edhe stafi ynë akademik: Ligj. Lindita Nebiu-Hyseni, PhD dhe Ass. Aferdita Ibrahimi, PhD. Ato prezantuan punimin me titull “Comparison of the Cloud Computing Platforms Provided by Amazon and Google”. Punimi u përcjell me komente pozitive nga kryetarja e konferencës znj. Helen Mitchel dhe pjesëmarrësit e tjerë të pranishëm.

Prezantim i suksesshëm i ligjërueses Dr. Lindita Nebiu-Hyseni, në Konferencën INTECH 2017 (IEEE) në Universitetin Publik University of Bedfordshire, në Mbretërinë e Bashkuar.

Nga data 16-18 gusht 2017, në Luton në Universitetin Publik - University of Bedfordshire në Mbretërinë e Bashkuar është mbajtur Konferenca INTECH 2017 e sponsoruar nga IEEE.

Në këtë conference ligjëruesja Dr. Lindita Nebiu Hyseni prezantoi rezultate të dalta nga puna në tezën e doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore (South East European University) në Tetovë, Maqedoni, nën udhëheqje të Prof. Dr. Zamir Dika, rektor. Prezantimi u përcjellë me komente shumë pozitive nga pjesëmarrësit dhe udhëheqësi i konferencës Prof. Dr. Ezendu Ariwa.





UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" SHKËMBEN PROFESORË ME UNIVERSITETET EVROPIANE

Në kuadër të programit evropian ERASMUS Mundus, si pjesë e aktiviteteve të projektit "GreenTech: Smart & Green Technologies for Innovative and Sustainable Societies in WB", prof. Elena Fatima Perez Carrillo po qëndron në Universitetin "Kadri Zeka". Ajo është pritur nga dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike Xhevdet Thaqi.



Një nga aktivitetet kryesore të Prof. Elena Perez Carrillo, është të përkrahë organizimin dhe fillimin me sukses të studimeve të programit master E-qeverisja, bazuar në metodologji dhe standarde evropiane.

Prof. Elena Fatima Perez Carrillo, vjen nga Universiteti i Leonit në Spanjë, në kuadër të këmbimit të stafit akademik ndërmjet universiteteve evropiane dhe Universitetit "Kadri Zeka" në Gjiçan, e që ka për qëllim të thellimin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve tona dhe organizimit të studimeve në UKZ në nivel evropian.

Përveç përkrahjes në programin master E-qeverisja, prof. Elena Perez do të zhvillojë aktivitete të tjera të rëndësishme për UKZ. Një nga kontributet e rëndësishme për zhvillimin e hulumtimeve shkencore do të jetë edhe themelimi i Qendrës Informuese Evropiane të Dokumentacionit në UKZ (European Documentation Centre or similar University located EU information Centre).

Ndryshe këtë vit akademik 5 studentë nga UKZ kanë përfituar grante për studime njëvjeçare në universitetet evropiane, në kuadër të projektit "GreenTechWB", kurse në kuadër të programit "Erasmus Mundus GREEN TECH WB", në muajin qershor të vitit 2016, Prof. Asoc. Dr. Xhevdet Thaqi pati përfituar si staf akademik për të qëndruar një muaj në Universitetin e Vigos të Spanjës, me qëllim të shkëmbimit të përvojave akademike universitare.

Studentë të Universitetit “Kadri Zeka” po arrijnë të bëhen pjesë e universiteteve më prestigjioze në Evropë falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që UKZ ka krijuar në kuadër të programit Erasmus Mundus – GreenTech WB. Në këtë vit akademik, disa prej tyre janë kthyer, por ka edhe të tillë që ende vazhdojnë studimet për një semestër në ato universitete.

Bionda Rexhepi studente e Fakultetit Juridik në Universitetin “Kadri Zeka”, tani është kthyer nga Universiteti i Splitit në Kroaci, ku ka ndjekur studimet Bachelor plot një vit akademik.



Erjona Huruglica, Kastriot Kadriu dhe Erleta Halimi, studentë të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjirokastrë, janë fitues të bursës dysemestrale, pjesë e mobilitetit të Projektit GreenTechWB, për studime në universitetet partnere të projektit Erasmus Mundus.

Ajo është shumë e lumtur që ka përjetuar një përvojë të re në studimet e saja. Për Bionden, kjo eksperiencë është një ndër eksperiencat më të mira që ka përjetuar deri më tani. Ajo thotë që çdo ditë atje ka qenë një sfidë e re dhe një mësim i ri. “Duke pasur parasysh që kam qenë në një qytet si Spliti dhe pata mundësi të studioj në një universitet evropian me bënë të ndihem e privilegjuar. Kjo eksperiencë më ka ofruar çdo ditë njohuri të reja. Përpos të tjerash, takimi me studentët të nacionaliteteve të ndryshme më ka ndihmuar shumë edhe në ndërtimin e personalitetit. Me plot bindje them se jam mësuar të mendoj në mënyrë kritike për çfarëdo aspekti ekonomik. Ndjej se kam fituar gjëra pozitive gjatë kësaj eksperience, të cilat me dëshirë do t'i ndaja me vendin tim në një të

ardhme shumë të afërt.”

Edhe Naxhije Rexhepi studente e Fakultetit Ekonomik, e cila kishte fatin të merrte bursë në Universitetin e Lubjanës të Sllovenisë, në kuadër të programit Erasmus+, është shumë e lumtur që kishte rastin të ndjek një vit studimet në këtë universitet. “Jam me fat që kisha rastin të prek ëndrrën dhe të shoh se si studiohet në një vend tjetër, të marrim njohuri të reja por mbi të gjitha të krijojmë kontakte me njerëz dhe kultura të ndryshme.

Të gjithë studentët u janë shumë falënderues Universiteti “Kadri Zeka” që po u krijon mundësi të ndjekin studimet edhe jashtë vendit. UKZ ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me programe dhe universitete të ndryshme të Evropës e botës.

Universiteti ynë ka marrëveshje me programin e Erasmus+ Mobility të Komisionit Europian, që ka për qëllim krijimin e mundësisë së shkëmbimi të studentëve për studimet themelore dhe postdiplomike dhe mobiliteti të stafit akademik për mësimdhënie.

Erjona Huruglica, studente e Fakultetit Ekonomik ka fituar bursën për të studiuar, po ashtu 10 muaj në Universitetin e Lubjanës të Sllovenisë.

Kastriot Kadriu student i Shkencave Komputerike, do të studiojë për 10 muaj në Universitetin e Teknologjisë dhe Metalurgjisë (në fushën e Informatikës) në Sofje të Bullgarisë.

Erleta Halimi studente e Fakultetit Ekonomik, ka fituar për të studiuar në Universitetin Ekonomik në Katovicë të Polonisë.

Studentët bursistë thonë se është kënaqësi që iu është dhënë rasti të jenë ndër studentët tjerë nga Universiteti “Kadri Zeka” për të ndjekur studimet në universitetet Evropiane.

Ata kanë falënderuar drejtuesit e universitetit tonë, të cilët kanë mundësuar që ata tashmë do të realizojnë ëndrrën studentore.

Studentët thonë se kjo është një mundësi shumë e mirë për të pasuruar studimet e tyre me përvojën e institucioneve arsimore perëndimore; njohjen e një kulture të re; ndërlidhjen me mësimdhënësit dhe studentët, si edhe përmirësimin e kompetencave individuale, si p.sh gjuha e huaj, komunikimi, marrëdhëniet ndërpersonale etj., që është vlerë e shtuar krahas studimeve të realizuara në vendin tonë.

Në ndërkohë në kuadër të mobilitetit të stafit akademik, në Universitetin “Kadri Zeka” do të qëndrojë prof. Elena Perez Carrillo nga Universiteti i Leonit (Spanjë).

PREZANTIMI I DYTË VJETOR I PROJEKTEVE NË FSHK

Më 16 shkurt 2018, u shpalosën rezultatet e punës së mësimdhënësve dhe studentëve të gjeneratës së dytë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike. Madhështia e këtij prezantimi të projekteve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike ishte edhe më domethënëse ngase iu kushtua 10-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Të kujtojmë se prezantimi I vjetor i projekteve të mësimdhënësve dhe tudentëve të gjeneratës së parë të FSHK-së ishte organizuar më 24 janar 2017.

Në prezantimin II të projekteve prezantoi Rectori i UKZ-së prof. Dr. Bajram Kosumi, prorektorët dhe menaxhmenti tjetër i UKZ-së, përfaqësues të kompanive të

rëndësishme të rajonit të Gjilanit si Fluidi, Grafofleks, Ridi.com, prof. Darlene Grant - Drejtoreshë e Peace Corps Kosovo, Profesori Stanley Mc Gahey nga SHBA, etj.

Me këtë rast, rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Bajram Kosumi, pasi ka uruar të gjithë të pranishmit për përvjetorin e pavarësisë së Kosovës, ka thënë se, nuk ka asgjë më të rëndësishme për këtë ditë, se sa puna konkrete e studentëve, respektivisht prezantimi i projekteve që sot po e bëjnë studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të UKZ-së, nën udhëheqjen e profesorëve të tyre.



Rectori Bajram Kosumi në hapjen e prezantimit të dytë të projekteve të FSHK-së

Ai njëherësh ka uruar studentët për panënë e bërë, derisa ka thënë se është i lumtur që i takon brezit të bërjes së shtetit të Kosovës dhe ndërtimit të tij.

Rectori Kosumi ka thënë se, sikurse ne, po ashtu edhe ju studentët, duhet të jeni krenar që jeni duke e krijuar historinë e shtetit, sepse Kosova është rast unik, andaj juve studentë të dashur ju ftoj që të besoni dhe të vazhdoni të punoni për ndërtimin e shtetit tuaj, vendit tonë - Kosovës.



Dekani i FSHK-së Xhevdet Thaqi, gjatë hapjes së prezantimit të dytë vjetor të projekteve të FSHK-së

Kurse dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Xhevdet Thaqi në fjalën e tij, ka uruar të gjithë studentët dhe stafin akademik të FSHK-së për punën e madhe që kan bërë në realizimin e këtyre projekteve, duke theksuar se krentrimi i 10-vjeotirt të Republikës së Kosovës me shpalosjen e këtyre rezultateve të tyre është dëshmia më e mirë për një të ardhme prosperuese edhe të studentëve, të fakultetit, universiteit dhe tërë Kosovës. Në vazhdim,

dekani Thaqi theksoi se Fakulteti i Shkencave Kompjuterike të UKZ, në punën mësimore dhe shkencore synon të realizojë objektivat e programit studimor duke bashkëpunuar me institucionet e tjera, si në sektorin publik, po ashtu edhe atë privat për të zhvilluar projekte në fushën e dixhitalizimit, zhvillimit të softuereve, ndërtimit të webfaqeve për promovimin të institucioneve-bizneseve dhe produkteve të tjera të shërbimeve online.



Prof. Darlene Grant drejtoreshë e Peace Corps Kosovo

Me një fjalë rasti para të pranishmëve kanë falur edhe Darlene Grant, Drejtoreshë e Peace Corps Kosovo, e cila e entuziazmuar nga rezultatet e prezentuara, i motivoi studentët të vazhdojnë edhe më me ngulm drejt rezultateve të reja edhe në të ardhmen. Edhe profesori Stanley Mc Gahey nga SHBA, i përshëndeti studentët dhe stafin akademik të FSHK-së për punën e bërë, duke theksuar se UKZ është një universitet me standarde bashkëkohore të arsimit të lartë.

Projektet në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike

Çka janë projektet dhe si organizohet puna në projekte të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike?

Lënda Projekti është lëndë obligative e paraparë për të dy specializimet (SEW respektivisht IE) në semestrin e V (pestë) të programit Shkencat Kompjuterike.

Lënda Projekti përfshin angazhimin që do ta kenë studentët e vitit të tretë në të dy specializimet, në kuadër të përmbushjes së punës praktike hulumtuese në lëndën Projekti në SEW dhe Projekti në IE, të paraparë nga Plani dhe Programi studimor i Programit të akredituar dhe riakredituar Shkencat Kompjuterike.

Ashtu si edhe është shënuar në Raportin e Vetëvlerësimit, lënda Proiekteti në SEW, respektivisht Projekti në IE ngërthen në vete një numër të konsideruar të kredive - gjithsej 8 ECTS. Qëllimi i këtij kursi është aftësimi praktik i studentëve dhe përbënë pjesën praktike të punës së studentit në zgjidhjen e ndonjë problemi të caktuar dhe të emërtuar nga mësimdhënësit e lëndëve profesionale. Mësimdhënësit e FSHK-së, paraprakisht hartojnë listën e problemeve/detyrave të titulluar lista e projekteve, në kuadër të të cilave duhet shtjelluar çështje të ndryshme

të identifikuar nga mësimdhënësit në bashkëpunim me insitucionet/kompanitë me të cilat UKZ ka marrëveshje bashkëpunimi.

UKZ- FSHK ka bashkëpunim me disa nga institucionet e rajonit të Gjilanit në realizimin e projekteve të ndryshme që mund të jenë pjesë e Projekteve të FSHK-së. Zgjidhja e këtyre detyrave/problemeve kërkon një lidhshmëri të njohurive teorike dhe praktike. Në kuadër të listës së projekteve, mund të shtjellohen edhe problematika të cilat ndërlidhen me inxhinieri kompjuterike (hardwarike dhe softwerike).

Me pëlqimin e Këshillit të Fakultetit, respektivisht dekanit të fakultetit, mund të merren në konsiderim edhe tema – projekte të cilat ndërlidhin IT me fusha të tjera (si shkenca natyrore, matematikë etj.).

Projekti punohet nga studentët individualisht (dhe në grupe). Studentët vlerësohen me notë e cila reflekton ngritjen e tyre profesionale. Mësimdhënësit do të propozojnë tema të projektit, të cilat pas aprovimit nga dekani (apo Këshilli i FSHK-së), publikohet dhe zgjidhen nga studentët.

Cilat ishin projektet e përzgjedhura të cilat u prezentuan në këtë ngjarje vjetore?

Në vazhdim po japim emërtimet e projekteve, emrat e studentëve dhe mësimeve, i cili ka koordinuar projektet e prezentuara.



Titulli i projektit: *Krijimi i Website-it për kompani ndërtimore dhe dekoruese (WebCo)*

Koordinatorë: Ligj. Dr. Linditë Hyseni-Nebiu

Studentët: Drilona Kurtalani, Arbitë Thaqi dhe Eldi Aliu.

Përshkrimi i projektit: Qëllimi i këtij projekti hulumtues dhe praktik është dokumentimi i projektit "Krijimi i website-it për kompani ndërtimi". Projekti është realizuar në bazë të kërkesave të kompanisë Rida-ks.com, kompani e cila merret me lyerje, dekorime, prodhim të elementeve dekorative dhe ndërtime të ndryshme. Website-i mundëson paraqitjen në kohë reale të projekteve në të cilat ka punuar kompania. Përpos krijimit të website-it apo modulit të përdoruesit është krijuar edhe moduli për administrimin e të dhënave. Ky modul bën që website-i të jetë dinamik, që nënkupton se çdo e dhënë që regjistrohet në këtë modul paraqitet në website pa intervenim në kod burimor. Për krijimin e modulit të përdoruesve dhe modulit të administratorit janë shfrytëzuar PHP dhe MySQL.



Titulli i projektit: Webaplikacion për menaxhimin e kërkesave për projekte (AppRequest)

Koordinator: ligj. Dr. Lindita Nebiu-Hyseni

Studentët: Florijan Ibrahim, Alban Kovani, Hydajet Qerimi, Flamur Aliloviq

Përshkrimi. Qëllimi i AppRequest është lehtësimi i punës për profesorët dhe studentët në zgjedhjen e temave në lëndën e projektit SEW/IE. Dizajni i këtij aplikacioni ka për bazë dizajnin e websajtit të universitetit “Kadri Zeka” në mënyrë që të mos krijoj ndonjë tranzicion dhe huti të madhe për përdoruesit pas hapjes së tij.

Për krijimin e web aplikacionit janë shfrytëzuar PHP dhe MySQL. Po ashtu janë shfrytëzuar HTML5, CSS3 dhe JavaScript. Projekti është realizuar në përputhje me rregulloren për projekte. Me rastin e integritit të web aplikacionit në serverin e UKZ-së, të mund të lidhet me databazën e sistemit elektronik për menaxhimin të studentëve (SEMS) për automatizimin e disa proceseve të cilat momentalisht duhet të kryhen nga përdoruesi, siç janë regjistrimi dhe dërgimi i transkriptave.



Titulli i projektit: Webaplikacion për menaxhimin e transfereve të studentëve (AppTrStudent)

Koordinator: prof.ass. dr. Artan Dërmaku

Studentët: Dritëlinda Hajdari, Dorlir Isufi, Erdonita Kërqeli, Miranda Kastrati dhe Armir Pajziti

Përshkrimi: Që në fillim bëhet një analizë e gjendjes faktike nëpër fakultetet, me fokus në shqyrtimin e procesit të transferit të studentëve nga një program studimor në një program tjetër studimor brenda apo jashtë universitetit. Mandej është punuar në digjitalizimin e këtij procesi, duke zhvilluar këtë projekt, i cili ka të bëjë me platformën online ku mundësohet transferimi i studentëve nga universitetet e tjera në UKZ. Mundëson automatizimin e bartjes së lëndëve dhe studentëve dhe në mënyrë automatike krijon dokumentin, i cili mbetet vetë për t'u nënshkruar. Projekti do të pritet mirë dhe pranohet nga të gjithë.

Titulli i projektit: Platforma e krijimit të CV on line (On-lineCVUKZ)

Koordinator: prof.ass. dr. Artan Dërmaku

Grupi i studentëve: Lentian Latifi, Miranda Kastrati, Erza Demi, Natyra Zeqiri, Faton Sherifi

Përshkrimi: Me krijimin e një uebfaqeje do të eliminoheshin problemet që zakonisht kanë të bëjnë me përpilimin e CV të personelit akademik dhe të studentëve. Për këtë qëllim Projekti mundëson platformën On-lineCVUKZ online ku profesorët updetojnë CV e tyre, kurse menaxhmenti ka mundësi të krijojë CV e stafit, raportet e ndryshme etj., në mënyrë automatike. E gjithë kjo me të paktën dy platforma të përcaktuara nga universiteti.

Titulli i projektit: Konfigurimi i e-learning në serverin e UKZ (ConServUKZ)

Koordinator: prof.ass. dr. Basri Ahmedi

Studentët: Qëndresa Shahini, Rinor Selimi, Ilmi Hajdini, Arbian Shkodra, Shkodran Berisha, Agnesa Tahiri.

Përshkrimi: Në kuadër të lëndës Rrjeta kompjuterike dhe Sisteme kompjuterike të shpërndara këtë semestër është zhvilluar një aktivitet praktik në formë të një projekti. Në realizimin e këtij projekti studentët janë përballë me veprime praktike të cilat kanë kërkuar angazhime për të zgjidhur problemet. Pika e përqendrimit të këtij projekti ka qenë pas instalimit të sistemit operativ windows server dhe platformave e tjera ndihmëse konfigurimi i sistemit për mësim elektronik Moodle 3.2. Kërkesa kryesore ka qenë përshtatja e këtij versioni me versionin paraprak i cili është përdorur si pilot-projekt në UKZ. Ky operacion është bërë në mënyrë profesionale. Është lidhur serveri me IP reale 80.80.173.124. Pas konstatimit që të gjithë veprimet e kërkuara funksionojnë është lidhur direkt me linkun oficial e-Learning të webfaqes së universiteti dhe tash Moodle vazhdon të përdoret. Pasi numër i madh i studentëve dhe profesorëve kanë krijuar llogari në serverin e vjetër ne kemi dhënë mundësi që materialet edhe një kohë të jenë në serverin e vjetër. Ato kanë të siguruar link nga ku mund të shërbehen.



Projekti: Aplikacioni për menaxhimin e termineve në spital (AppMTS)

Koordinator: prof.ass. dr. Basri Ahmedi

Studentët: Valmir Sallahu, Adhurim Bajrami, Endrina Spahiu, Valentina Hajdari, Safete Sadiku, Mirgete Bajrami, Amire Islami

Përshkrimi: Sot janë krijuar disa kushte elementare siç janë funksionimi i rrjetave lokale, përdorimin internetit nëpër institucione, posedimi i PC-ve në institucione dhe familje, pajisjet mobile, rritja e shkallës së edukimit për IT etj. Duke pasur parasysh këtë kemi menduar se mund të bëhet një aplikacion, i cili do të lehtësojë komunikimin në mes pacientit dhe mjekut. Është bërë analiza e kërkesës, duke bërë anketa dhe pyetësorë. Është krijuar një webaplikacion, duke përdorur gjuhët HTML, CSS dhe PHP. Është shfrytëzuar platforma MySQL për bazën e të dhënave. Të vetëdijshëm se webaplikacioni mund të përmirësohet edhe më tej me veprime shtesë.

Në fund, rektori prof.dr. Bajram Kosumi dhe dekani i FSHK-së ndan mirënjohje për mësimdhënësit dhe studentët për projektet e prezantuara.



Studentët e gjeneratës së dytë të FSHK-së, pas prezantimit të projekteve

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" NË GJILAN ANËTAR I FONDIT EVROPIAN TË UNIVERSITETEVE (EUF)



Në mbledhjen e rregullt të Bordit Drejtues të EUF mbajtur më 9.12.2017, Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan u pranua anëtar i Asocuar i Fondit Evropian të Universiteteve (EUF).

Së shpejti do të vendosen edhe vijat e rregullta të bashkëpunimit nga i cili do të përfitojnë studentët dhe stafi akademik i UKZ-së.

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" NË GJILAN BËHET ANËTARE E ENAI



Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan është pranuar anëtar i Rrjetit Evropian për Integritetin Akademik.

Bordi i Rrjetit Evropian për Integritetin Akademik (ENAI) ka pranuar Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, anëtar zyrtar të ENAI.

Ky rrjet promovon integritetin në akademi, përmes ndarjes së praktikave dhe përvojave më të mira, zhvillimit të materialeve dhe bashkëpunimit në adresimin e çështjeve etike në akademi.

UKZ vlerëson që anëtarësimi në këtë rrjet është shumë i rëndësishëm për të mësuar praktikatat më të mira të integritetit akademik nga universitetet evropiane, anëtare të këtij rrjeti.


ENAI mbështetet nga projekti ERASMUS+, program i Bashkimit Evropian.

PËRSHTYPJET E STUDENTËVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

Në fund të vitit akademik 2016/2017, filloi puna rreth diplomimit të studentëve të parë në Fakultetin e Shkencave Kompiuterike. Kështu në afatin e qershorit dhe të shtatorit të vitit 2017 u diplomuan me sukses 20 studentët e parë. Për këta dhe studentët e fakulteteve të tjera të UKZ-së u organizua edhe ceremonia e diplomimit të tyre. Sivjet, po përfundon studimet bachelor edhe gjenerata e dytë. I gjithë stafi menaxhues i UKZ-së dhe i FSHK-së është i preokupuar për studime cilësore në FSHK. Rritja e cilësisë së studimeve është një proces në të cilin studentët duhet të marrin pjesë aktive. Për këtë qëllim, në vazhdim po japim intervistat me studentët të cilët kanë diplomuar në FSHK dhe studentët të cilët aktualisht studiojnë në FSHK. Atyre u shtruum dy pyetje:

Cilat janë përshtypjet tuaja, lidhur me studimet në FSHK të UKZ-së dhe cila është perspektiva e studentëve të diplomuar në FSHK të UKZ?

Jeton Selimi



Të jesh student i gjeneratës së parë në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjiilan ishte privilegj i madh, sidomos në Fakultetin e Shkencave Kompiuterike. Kam pritur me vite të studioj një drejtim të tillë, me të cilin mund ta gjej veten në të ardhmen. Universiteti "Kadri Zeka" ishte ai, i cili ma dha mundësinë të studioj drejtimin

e duhur, nga i cili kam përfutur shumë, falë stafit akademik që posedon dhe kontributit të tyre që dhanë, ku në vitin 2017 edhe përfundova studimet.

Profesorët kanë qenë mjaft komunikativë me studentët dhe shumë bashkëpunues, që në universitetet e tjera, ndoshta nuk ekziston një mundësi e tillë.

Cilësia që ka ky fakultet është një tipar që mund të bëjë diferencën më të madhe të FSHK-së nga fakultetet e tjera duke marrë parasysh se FSHK është fakultet më i ri, mirëpo ajo që po dëshmohej është nxjerrja e kuadrove mjaft të suksesshme nga ky fakultet.

Mund të them se kam arritur të përfitoj shumë nga Universiteti "Kadri Zeka" në Gjiilan, përkatësisht nga Fakulteti i Shkencave Kompiuterike dhe kam arritur t'i realizoj dëshirat e mia të kamotshme.

Fakulteti i Shkencave Kompiuterike hap mundësi të mëdha për punësim në shumë pozita të ndryshme fal inovacioneve të mëdha teknologjike, është drejtim me perspektivë aktualisht dhe do të jetë edhe më shumë perspektivë në të ardhmen.

Me rastin e diplomimit tim perspektiva e parë ishte punësimi im në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët, si mësimdhënës i Teknologjisë, ku e ndjej veten mjaft të kënaqur njëherit edhe sfidues. Tani jam duke vijuar studimet master në programin E-Qeverisja në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjiilan.

Studentët të cilët dëshirojnë të kenë një jetë me sfida dhe me shumë perspektivë, atëherë i rekomandoj të studiojnë në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjiilan, përkatësisht në Fakultetin e Shkencave Kompiuterike, i cili ua mundëson një gjë të tillë, mirëpo kjo do të varet edhe nga angazhimi i tyre në arritjen e objektivave për një të ardhme më të sigurt.

Eda Agushi



Përshtypjet e mia rreth përfundimit të fakultetit në Universitetin "Kadri Zeka" janë të mrekullushme. Kam përfunduar vitin akademik në qershor të 2017, si dhe diplomova po atë vit në afatin e shatorit. Fakulteti i Shkencave Kompiuterike më hapi shumë rrugë që ta vazhdoj karrierën time drejt qëllimeve dhe synimeve të mia.

Në përfundim të studimeve të bachelorit, pak para diplomimit fillova punën praktike në Prishtinë, në një kompani të IT-së. Aty vazhdoja për 6 muaj punën praktike dhe pas kësaj arrita të punësohem dhe jam shumë e lumtur dhe krenare për arritjen e kësaj pune si Web Developer dhe Database Designer në kompanin e Vision Agency.

Për të gjithë ata që janë afër përfundimit apo edhe në fillim të studimeve në fushën e IT-së me shumë bindje e them që të vazhdojnë përpara, sepse teknologjia dita ditës po zhvillohet në masë të paparashikueshme dhe se depërtimi në punë është shumë më i lehtë, mjafton që të kesh ambicie dhe vullnet.

Arllind Kryeziu




Studimi në Universitetin "Kadri Zeka", sidomos në drejtimin e Shkencave Kompiuterike, si gjenerata e parë e këtij drejtimi, ishte një nder i madh për mua. Drejtimi i Shkencave Kompiuterike ishte ai që më shtyri drejt studimit në këtë universitet dhe më ka befასuar cilësia dhe profesionalizmi i treguar nga stafi akademik, edhe pse i ri si fakultet. Profesorët kanë

qenë shumë bashkëpunues dhe na kanë ofruar përkrahje maksimale në çdo aspekt.

Me rastin e diplomimit tim perspektiva e parë ishte punësimi në kompanin "CREA-KO" si zhvillues (programer) dhe implementues i aplikacioneve, ku e ndjej veten mjaft të kënaqur njëherit edhe sfidues.

Drejtimi i Shkencave Kompiuterike të ofron një jetë të mbushur me sfida, por me më shumë kënaqësi dhe nëse ky është drejtimi që dëshironi ta merrni, Universiteti "Kadri Zeka" është vendi i duhur.

Buen Bajrami



Unë, si student i shkencave kompjuterike, jam shumë i kënaqur me jetën studentore në universitetin tonë. Më ka përmbushur, qoftë në aspektin shkencor apo shoqëror. Stafi akademik është mjaft konkurrues me rajonin, janë bashkëpunues dhe të aftë. Mbi të gjitha janë shumë të drejtë me studentët. Personalisht mund

të ndaj vetëm përvoja të mira. Si gjeneratë e parë, ishte mjaft sfidë, por jam i lumtur që krijuam një bazë të fortë për gjeneratat e ardhshme të cilat besoj se do ta forcojnë edhe më shumë emrin e universitetit tonë.

Unë besoj se universiteti ynë po krijon një perspektivë gjithnjë e më të madhe për studentët. Duke filluar nga bursat, ku kisha nderin të isha studenti i parë në Universitetin që fitova një bursë për studime në Gjermani në drejtimin shkencë kompjuterike. Gjithashtu, jemi përgatitur për tregun e punës. Momentalisht jam duke ndjekur studimet master dhe ushtrij detyrën e menaxherit në një kompani që merret me instalimin dhe programimin e sistemeve të kontrollit. Ëndrra ime është vazhdimi i karrierës akademike deri në nivelet më të larta dhe të ofroj një shembull të mirë për studentët.

Aurora Mehmeti



E entuziazmuar dhe me dëshirë të madhe për të filluar këtë udhëtim të ri jetësor, si studente në Shkencë Kompjuterike në Universitetin "Kadri Zeka" nisi dita e parë.

Që në ditët e para jam bindur që kam bërë zgjedhjen e duhur. Edhe pse si çdo fillim, fillimi i semestrit të parë ishte i vështirë, sfidues dhe paksa i frikshëm. Por, këto vështirësi

dhe këto sfida u lehtësuan fal punës së palodhshme dhe të vazhdueshme të profesorëve tanë.

Profesorët janë ndër më të mirët në fushën e tyre dhe metodat e tyre të shpjegimit bazohen në zhvillimin e mendimit kritik të studentëve. Ata ishin shumë bashkëpunues me studentët dhe të gatshëm të na ndihmonin në gjërat që kishim paqartësi. Leximi dhe hulumtimi janë çelësi i arritjes së suksesit dhe kërkojnë shumë angazhim, prandaj shumica e kohës gjatë javës i kushtohet leximit të pavarur dhe kërkimit, e për këtë arsye biblioteka e universitetit është vendi i preferuar i studentëve.

Studentët e Universitetit "Kadri Zeka" janë shumë entuziastë për të mësuar dhe për të arritur rezultate, kështu që ka shumë mundësi që nga ky universitet të dalin emrat e mëdhenj të së ardhmes së shkencës.

Përveç kësaj të gjithë janë shumë miqësorë dhe të gatshëm për të ndihmuar.

Edhe pse Universiteti "Kadri Zeka" është i ri, ka arritur të

zhvillohet shumë e të arrijë suksese të mëdha, që ndoshta universitetet e tjera, edhe pse me traditë më të gjatë, ende nuk i kanë arritur si kriimi i ambientit të ngrohtë mësimi dhe edukimi, prandaj unë jam shumë e lumtur që këtë edukim dhe këtë eksperiencë kaq të bukur të jetës sime po e përjetoj në Universitetin "Kadri Zeka" dhe do t'i inkurajoja të gjithë për një eksperiencë të tillë.

Dritëlinda Hajdari



Si studente e Universitetit "Kadri Zeka" në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, mund të them se në këtë universitet ia vlen të studiojmë. Këtu ka një kuadër profesional akademik dhe programe të përkryera të studimeve. Edhe pse është një Universitet i ri, i përmbush kushtet e nevojshme për studime të sukseshme.

Pika kryesore e universitetit tonë është stafi akademik, i cili është bashkëpunues me studentët dhe gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar dhe përkrahur studentët gjatë studimeve dhe ideve të reja që ata sjellin rreth zhvillimit të fushave dhe drejtimeve të ndryshme. Gjatë këtyre viteve të studimeve profesorët tanë kanë ndarë dijen e tyre me ne, duke rezultuar kështu në zgjerimin e dijes sonë.

Në fillim të studimeve, sikurse shumica e studentëve edhe unë shpesh brengosesha nëse kam bërë zgjedhjen e duhur rreth vazhimit të studimeve në Universitetin "Kadri Zeka", mirëpo tani me plot bindje mund të them se Universiteti "Kadri Zeka" ishte zgjedhje e duhur dhe i ftoj edhe gjeneratat e ardhshme të vinë të studiojnë në Universitetin "Kadri Zeka".

Lumturije Morina



Unë jam studente e Universitetit "Kadri Zeka" në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, në vitin e dytë. Eksperiencat e mia për teknologji para se të filloj fakultetin nuk ishin të mëdha, por gjithnjë idetë dhe dëshira për të realizuar diçka më ndryshe ekzistonte dhe për këtë arsye vendosa që të vazhdoj studimet në këtë fushë.

Pasi kam filluar me studime kam njohur shumë profesorë dhe shumë asistentë që me të vërtetë me çdo student janë sjellë si është më së miri, është me të vërtetë kënaqësi të punosh me ta, pasi ky fakultet është një fushë ku nuk të duhet vetëm teoria por dhe praktika dhe me të vërtetë në bashkëpunim me profesorët kemi arritur të krijojmë shumë projekte, ku jemi aftësuar për zgjidhje të problemeve të ndryshme digjitale. Pasi kam përfunduar me sukses vitin e parë, jam shpërblyer me bursë universitare dhe jam e gëzuar që kam arritur diçka me punën time. Është kënaqësi të jesh pjesë e këtij stafi kaq të shkëlqyer. I falënderoj të gjithë profesorët dhe asistentët për punën që e bëjnë për ne.

